

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ambasadori kroat nga Pogradeci: Protestat janë e drejtë e qytetarëve, qeveria duhet të dëgjojë mesazhi n e tyre! Kramariç: Brezi i ri mund t'i japë fund tranzicionit
ADRESA	https://albeu.com/lajme/ambasadori-kroat-nga-pogradeci-protestat-jane-e-drejte-e-qytetar-eve-qeveria-duhet-te-degjoje-mesazhin-e-tyre-kramaric-brezi-i-ri-mund-ti-jape-fund-tranzicionit/1012678/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:08:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:04:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b69926191db0ba3f51e324f65f1b2688bb3a5d8dbff71158f4f865394b7dce7a
TEKSTI	82b63a5500bd6bba640a5daac85b1e208daec92533721627d878fedaf14e20d9
PAMJA	a89cbff60cf6de0e930f3ae45381936475557b2f393f051a86e4620bc67d3985

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f0a4a1c6c6e827bba92b3f1b5211cf0ac3149b400ec89984f12dc21d4f7628dd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f0a4a1c6c6e827bba92b3f1b5211cf0ac3149b400ec89984f12dc21d4f7628dd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ambasadori kroat nga Pogradeci: Protestat janë e drejtë e qytetarëve, qeveria duhet të dëgjojë mesazhin e tyre! Kramariç: Brezi i ri mund t'i japë fund tranzicionit



Nga Pogradeci, ambasadori i Kroacisë në Shqipëri, Zlatko Kramarić, deklaroi se qytetarët shqiptarë duhet të kenë lirinë të shprehin nevojat dhe shqetësimet e tyre. Duke iu referuar protestave në vend, ai tha se ato përbëjnë një mesazh politik për qeverinë, e cila duhet ta dëgjojë dhe ta marrë në konsideratë atë.

Kramarić ndodhet në Pogradec për një projekt të organizuar nga Ambasada e Kroacisë në bashkëpunim me Këshillin e Studentëve të Shqipërisë. Nisma synon të përcjellë përvojën kroate mbi hapat e ndërmarrë përpara anëtarësimit në Bashkimin Europian, si dhe të përgatisë brezin e ri për këtë proces.

Ambasadori u shpreh se protestat pasqyrojnë ndjeshmërinë e qytetarëve ndaj çështjeve të tilla si ekologjia, qeverisja dhe mënyra se si funksionojnë institucionet. "Protesta është një e drejtë e qytetarëve. Aty nuk është diskutimi kanë apo nuk kanë të drejtë, por qytetarët duhet të jenë të lirë të shprehin nevojat dhe dëshirat e tyre. Ky është një mesazh për qeverinë. Çdo qeveri duhet të marrë mesazhin që i shkon në aspektin politik", tha ai.

Duke folur për reformat që i nevojiten Shqipërisë, Kramarić theksoi se ato nuk duhet të konsiderohen vetëm si kërkesa të Brukselit, por si procese që u shërbejnë drejtpërdrejt qytetarëve. "Reformat nuk duhet të shikohen si tip gjobash, pra nuk duhet të shikohen siç e kërkon Brukseli dhe duhet bërë, sepse mbi të gjitha janë qytetarët që jetojnë në këtë vend", u shpreh ambasadori.

Sipas tij, zbatimi i reformave mund të kërkojë kompromise dhe marrëveshje, ndërsa ligjet duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të mos zbatohen në mënyrë të diferencuar. "Ligji nuk duhet të bëhet selektiv vetëm për një pjesë të qytetarëve. Është fjala që për dikë lejohet dhe për dikë nuk lejohet", deklaroi Kramarić, duke shtuar se ndryshimet e lidhura me integrimin në BE duhet të sjellin përfitime për qytetarët shqiptarë.

Ambasadori vlerësoi gjithashtu të rinjtë shqiptarë, të cilët i cilësoi të arsimuar dhe të gatshëm për të marrë përgjegjësi në ekonomi e politikë. Ai tha se gjenerata e re mund t'i japë fund tranzicionit shqiptar. "Qëllimi nuk është të bëjmë rolin e pedagogut, por të shpërndajmë eksperiencën tonë në këtë proces", tha Kramarić, duke nënvizuar se në Shqipëri ekziston një mbështetje shumë e lartë për integrimin europian.

të fundit /



Ambasadori kroat nga Pogradeci: Protestat janë e drejtë e...



Eksptert paralajmërojnë për rreziqet e AI-së, ndër...



Çfarë fshehin timonët e biçikletave me qira në Londër? Analizat...



John Ternus surprizon në Emmy Awards, prezanton para...



Ron Raçi shpallet pjesë e formacionit të javës në Kroaci pas...



Jack Thorne ngre shqetësimin për ndikimin e IA-së te...



Range Rover ndryshon drejtim: më pak ekrane për një kabinë më të...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

I pyetur për gjyqin ndaj drejtuesve të UÇK-së në Hagë, Kramariç kujtoi se ka shërbyer si ambasadori i parë i Kroacisë në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë së saj, kur Hashim Thaçi ishte kryeministër. "Jam njohur me të. Mund të themi që vendimi i gjykatës duhet të pranohet edhe pse mund të jetë i dhimbshëm. Pra duhet të shohim të dyja anët. Nga njëra anë çështja Thaçi dhe nga ana tjetër çështja e Kosovës", tha ai.

Kramariç vlerësoi se një dënim i Hashim Thaçit nuk do të ishte pozitiv për imazhin e Kosovës si shtet, por theksoi se, pavarësisht vendimit, përgjegjësia për të nuk i përket Kosovës si shtet. "Shpresoj që procesi mos ketë qenë politik, por i drejtë", përfundoi ambasadori.

Shtuar më 15.09.2026 15:04


Tags: [-Politikë](#), [ambasadori](#), [kroaci](#), [kryesorë](#),
[Lajmet e fundit](#), [Shqipëria](#), [Të Gjitha](#), [Zlatko](#)
[Kramariç](#), [ZZ-Instant](#)




Përplasja në Komisionin e Ligjeve, Korreshi i përgjigjet Gogut për "barsoletën" d...



Arrestohen në Athinë dy grekë që dyshohet se tentuan të vidhnin një motor



Daja i Zegjine Çaushit më çoi në ferra dhe abuzoi me mua/ Rrëfehet 34-vjeçarj...



Goditet banda shqiptare e kokainës në Belgjikë, 8 të arrestuar, mes tyre Gert...



Mes dy hidrocentraleve, fshati Madhesh në Mat prej afro 20 vitesh pa energji...



E trishtë/ Ndahet nga jeta ish-deputetja e Kosovës (EMRI)



Trump publikon heliportin e ri në Shtëpinë e Bardhë: Synoj t'i rikthej rezidencë...



OKB-ja thërret mbledhje urgjente për kontrollin e Ngushticës Bab el-Mand...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

[Erion Veliaj](#)
[Free Esim](#)
[Zgjedhjet 2025](#)
[Belinda Balluku](#)
[SPAK](#)
[Kombëtarja](#)

Kategori

[Lifestyle](#)
[Showbiz](#)
[Tech](#)
[Shëndetësi](#)
[Argetim](#)
[Enciklopedi](#)

Linqet

[Live tv shqiptare](#)
[Moti në Shqipëri](#)
[Travel](#)
[Horoskopi](#)
[Livescore](#)
[News from Albania](#)

Tags

[Edi Rama](#)
[Albania News](#)
[Ilir Meta](#)
[Piranjat](#)
[gazeta, tv, portale](#)
[Sali Berisha](#)

Moti

[Moti në Tiranë](#)
[Moti në Prishtinë](#)
[Moti në Shkup](#)
[Moti në Durrës](#)
[Moti në Prizren](#)
[Moti në Tetovë](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.